


Komuna Vushtri



Komuna Obiliq

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI

PËR FINANCIMIN E PËRBASHKËT TË PROJEKTIT “NDËRTIMI – REHABILITIMI I KANALIZIMIT NË FSHATRRAT STANOC I EPËRM – BREZHNICË – KOZARICË”

Palët Nënshkruese,

1. Komuna e Obiliqit, përfaqësuar nga **z. Xhafer Gashi**, Kryetar i Komunës,
2. Komuna e Vushtrisë, e përfaqësuar nga **z. Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është financimi i përbashkët i projektit “**Ndërtimi - Rehabilitimi i Kanalizimit në Fshatrat: Stanoc i Epërm – Brezhnicë – Kozaricë**” dhe përcaktimi i obligimeve të palëve të kësaj marrëveshje për realizimin e këtij projekti.

Neni 2 Financimi i projektit

Komuna e Obiliqit do të financojnë projektin “Ndërtimi -Rehabilitimi i Kanalizimit në Fshatrat: Stanoc i Epërm – Brezhnicë – Kozaricë” nga buxheti i saj në vlerë prej 20,000.00 €, ndërsa Komuna e Vushtrisë do të participoj me shumën tjetër të mjeteve financiare që do të nevojiten për realizimin e këtij projekti.

Neni 3

Obligimet e Komunës së Vushtrrisë

3.1 Komuna e Vushtrrisë merr përsipër që për projektin “Ndërtimi – Rehabilitimi i Kanalizimit në fshatrat: Stanoc i Epërm – Brezhnicë – Kozaricë”, të zbatojë procedurat e prokurimit konform ligjit në fuqi për prokurimin publik.

3.2 Komuna e Vushtrrisë cakton menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e realizimit të projektit si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.

3.3 Menaxheri i projektit përkatësisht organi mbikëqyrës, me përgjegjësi të plotë vërteton kualitetin e punëve të kryera në bazë të cilave operatori ekonomik lëshon dokumentin financiar me kërkesë për pagesën e punëve të kryera në bazë të kushteve të kontratës.

3.4 Komuna e Vushtrrisë do të ndërmerr të gjitha masat e nevojshme që projekti të përfundojë gjatë vitit buxhetor 2019.

3.5 Komuna e Vushtrrisë do ta njoftoj Komunën e Obiliqit për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani një mujor deri në përfundimin e projektit.

Neni 4

Obligimet e Komunës së Obiliqit

4.1 Komuna e Obiliqit obligohet që para fillimit të procedurave të prokurimit të ia dorëzojë komunës së Vushtrrisë dëshminë për zotim të mjeteve për këtë projekt ndërsa do të i transferoj mjetet nga buxheti i saj komunës së Vushtrrisë pas dorëzimit të raportit nga komisioni për pranim teknik të projektit.

4.2 Komuna e Obiliqit do të caktoj një zyrtar profesional i cili do të bashkëpunoj me organin mbikëqyrës të Komunës së Vushtrrisë, për përcjellje të realizimit të projektit nga kjo marrëveshje.

Neni 5

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

5.1 Me pëlqimin paraprak të Kryetarit të Komunës së Obiliqit dhe Kryetarit Komunës së Vushtrrisë, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim të ndërsjellë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Palët nënshkruese pajtohen që marrëveshje e mirëkuptimit të hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit.

Neni 8
Numri i ekzemplarëve


Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër ekzemplarë, nga dy për secilën palë nënshkruese.

Komuna Obiliq


Xhafer Gashi, Kryetar



Komuna Vushtri


Xhafer Tahiri, Kryetar